

URDHËR
Nr. 119, datë 21.8.2024

**PËR DELEGIMIN E PËRKOHSHËM TË KOMPETENCËS PËR MBIKËQYRJEN E
VEPRIMTARISË ADMINISTRATIVE TË AGJENCISË SË MENAXHIMIT TË
GARANCIVE DHE KREDIVE TË PAKTHYERA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të neneve 11, 22 dhe 23, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të germës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe të shkresës së Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera me nr. 3792 prot., datë 9.8.2024, “Kërkesë për orientim dhe marrje masash”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencës për ushtrimin e mbikëqyrjes së veprimtarisë administrative të Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera (AMGKP), z. Besmir Beja, Sekretar i Përgjithshëm, në Ministrinë e Financave, deri në emërimin e titullarit të AMGKP-së, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Z. Besmir Beja, Sekretar i Përgjithshëm, në Ministrinë e Financave, ngarkohet të ushtrojë të drejtat e zyrtarit përgjegjës për mbikëqyrjen e Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera (AMGKP), në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.

3. Delegimi i kompetencës fillon me hyrjen në fuqi të këtij urdhri dhe mbaron me shfuqizimin e tij.

4. Ngarkohet z. Besmir Beja, Sekretar i Përgjithshëm, në Ministrinë e Financave, Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera për zbatimin e këtij urdhri, si dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Ministrinë e Financave, për komunikimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj